



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .11.2022

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga kryetari i Shoqatës Kulturore në diasporë Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptar në Itali.

Z. Skënder Lazaj
Email- lazajskender@gmail.com

I nderuar z. Lazaj,

Së pari, përfitojmë nga rasti që t'ju falenderojmë për besimin e treguar në punën e institucionit tonë dhe rëndësinë që i jepni procesit të kontrollit dhe verifikimit të cilësive etiko morale me qëllim pasjen e figurave të pastra në detyrat funksionale, proces në të cilin Autoriteti po bashkëpunon ngushtësisht me çdo institucion.

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, email i datës 22.11.2022 dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës kërkon;

- o informacion për një anëtar të shoqatës për të cilin keni dyshime se ka qenë në shërbim të ish-Sigurimit të shtetit, ju informojmë si më poshtë:

Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, në rastin konkret *institucionet kushtetuese apo autoritetet publike për verifikim zyrtarësh që emërohen apo ngrihen në detyrë, kandidatët për deputet/kryetar bashkie apo subjektet politike në rastin e të zgjedhurve, por edhe cdo person kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit* të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre.

Bazuar në nenin 29 të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, kur kërkesa bëhet për shkak të emërimit/ ngritjes në detyrë së zyrtarëve, për procesin e verifikimit të pastërtisë së figurës në institucion, është e nevojshme që secili prej shtetasve pra kandidatëve, të plotësojë formularin e aplikimit për zyrtarë në të gjitha rubrikat e tij. Kopje të këtij formulari e gjeni bashkëlidhur shkresës.

Kërkesa mund të bëhet edhe për qëllim të njohjes me dokumentet kur shtetasi ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit të ish-Sigurimit të Shtetit, kërkesë e cila ka bazë ligjore nenet 19, 20 e në vijim të ligjit nr. 45.2015. Çdo individ në cilësinë e kërkuesit ka mundësi të aplikojë për informacion në Autoritet, *për veten ose të afërmit të tij* brenda parashikimit të ligjit 45/2015, duke plotësuar formularin përkatës për individë të miratuar nga Autoriteti të cilin e gjeni bashkëlidhur.

Vetëm pas plotësimit të kushteve të mësipërme të parashikuara nga ligji nr 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti do të vijojë me trajtimin e kërkesës për verifikim, apo për njohje me dokumentet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit

L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Në mungesë dhe me Urdhër

Drejtori i Informacionit

Selami Zalli